



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

TREGU NDËRKOMBËTAR DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I VENDIT

Ismail Mehmeti, PhD

Kolegji "Pjetër Budi"

Dogana Kosovës

ismajlm@hotmail.com

Naim Kamberaj, PhD

Auditor i Brendshëm, Dogana e Kosovës

naim.kamberaj@gmail.com

Abstrakt:

Tregu ndërkombëtare ka një ndikim të madhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, subjektet ekonomike vendore janë shumë të interesuara për të marrë pjesë në tregun ndërkombëtar dhe varësisht nga niveli i pjesëmarrjes së një vendi në tregun ndërkombëtarë përcaktohet edhe ndikimi i atij vendi në zhvillimet ekonomike globale. Për të kuptuar pozitën e një vendi në ekonominë ndërkombëtare duhet të dihen disa karakteristika të atij vendi siç janë: çfarë territori ka ai vend, sa është numri i popullsisë së atij vendi, çfarë burime energjetike ka, a e ka të zhvilluar tregun e brendshëm dhe deri në çfarë niveli etj. Me pjesëmarrje të suksesshme në tregun ndërkombëtarë subjektet vendëse përfitojnë në shumë aspekte, në aspektin financiar, të punësimit, prodhues duke rritur kualitetin e produkteve, rritje të konkurrencës dhe përfaqësim të shtetit etj, e gjithë kjo pastaj ndërlidhet me ekonominë e një vendi sepse dalja e subjekteve vendore në tregun ndërkombëtarë krijon zhvillim, mirëqenie dhe stabilitet më të madh ekonomikë në një vend.

Asnjë vend nuk arrin që ti plotëson të gjitha nevojat e veta me të mira materiale për arsye qoftë klimatike, të relievit gjeografik, të pasurive nëntokësore, pozitës gjeografike bregdetare, etj, duke u nisur nga kjo edhe shkëmbimi i ndërsjellë i mallrave, i shërbimeve, i lëndëve të para dhe gjysmë produkteve, etj, në mes të këtyre shteteve është i domosdoshëm e gjithë kjo arrihet përmes tregut ndërkombëtarë i cili treg ka rregulla formale që duhen respektuar nga vendet që pretendojnë të inkuadrohen në këto rrjedha, si për shembull standardi për cilësi të mallit, kushtet e tregimit që nënkupton sigurimin e mallit për transport, respektimi i kontratave të nënshkruara-formimi i gjykatave për arbitrazhe, mbikëqyrja e tregjeve të letrave me vlerë, zgjidhja e kontesteve tregtare etj.

Fjalët kyçe: *Tregtia ndërkombëtare, subjektet ekonomike vendore, politika tregtare, mirëqenia ekonomike, zhvillimi ekonomik, rregulla formale etj.*